



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.161/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ, të paditësit “P...”, SH.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e avokatëve “...”, Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – ndëshkim tatimor, vlerë kontesti 7,032.21 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 28.09.2022, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Avokat S.E nga shoqëria e avokatëve “...”, dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tersi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit “P...”, SH.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e avokatëve “...” – Prishtinë.
- II. ANULOHET vendimi i të paditurit, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr. 02/2020, i datës 26.02.2020.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësin, “P...”, SH.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e avokatëve “...” – Prishtinë, t’ia kthej mjetet e paguara nga pagesa e gjobës administrative në shumë prej 6,032.51 euro, (gjashtëmijë/e/tredhjet/e/dy/euro/e/pesëdhjetë/e/një/cent), sipas dokumentit të vendosjes së ndëshkimit nr. MFA2R0000104015/14.12.2017, nga pagesa e gjobës administrative në shumë prej 1,000.00 euro, (njëmijë/euro), sipas dokumentit të

vendosjes së ndëshkimit nr. MFA2R0000104016/14.12.2017, dhe atë në shumë të përgjithshme prej 7,032.51 euro, (shtatë mijë/e/tridhjetë/e/dy/euro/e/pesëdhjetë/e/një/cent) me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave, punës dhe transfereve e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muajin kalendarik në mes të datës së pagesës nga paditësi dhe datën kur e paditura e referon për pagesë-rymbursim Ministrisë së Financave, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit ligjor.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në gjykatë me datë 09.04.2020, ka kundërshtuar vendimi i të paditurit, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr. 02/2020, i datës 26.02.2020, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, për shkak se në procedurë që i ka parapri aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës sepse është konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të drejtë gjendja faktike, dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata ta aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar, ta anuloj vendimin 02/2020, i datës 26.02.2020, dhe dokumentet e vendosjes së ndëshkimeve MFA2R0000104015/14.12.2017, dhe MFA2R0000104016/14.12.2017, dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia kthej shumën prej 7,032.21 euro. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se: E paditura konstatimin e saj lidhur me kinse malli pa origjinë të paditëses nuk e baton në asnjë provë të vetme, ndërsa në tërësi nuk i trajton provat materiale të paraqitura nga paditësja lidhur me pronësinë dhe destinacionin e mallit lëndor. Paditësja përmes provave materiale, përkatësisht përmes DUD-it importues, Fletë Dërgesës së mallit dhe Faturës së shitjes së mallit e dëshmon pronësinë dhe destinacionin e mallit lëndor, ndërsa e paditura duke i anashkalluar këto prova materiale ka nxjerrë konstatim të gabuar të gjendjes faktike kinse malli është pa origjinë, duke cekur vetëm deklaratën e shoferit, mirëpo sipas Udhëzimit Administrativ Nr.15/2010, përkatësisht neni 19 par.4 përcakton se pronësia apo destinacioni i mallit duhet të verifikuar në bazë të dokumentacionit, dhe jo në bazë të

deklarimit kinse të shoferit, e cila deklaratë asnjëherë nuk është administruar si provë, dhe shoferi i cili pretendohet se ka deklaruar ashtu asnjëherë nuk është dëgjuar në asnjë cilësi. Vendimin e të paditurës e kontestojmë edhe për faktin se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me pikëpamjet dhe qëndrimin juridik të dhënë në aktgjykimin A.nr.757/17 me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe lënda ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura, mirëpo e paditura duke vepruar në rishqyrtim dhe rivendosje përsëri e ka nxjerrë aktin e njëjtë i cili ishte anuluar me aktgjykimin e lartcekur të formës së prerë. Po ashtu, paditësja në këtë seancë paraqet provat, respektivisht pagesat e ndëshkimit administrativ në shumë prej 6,032.51 €, Pagesa Bankare e datës 19.04.2017 dhe Pagesën e Gjobës Administrative në shumën prej 1,000 € sipas dëshmisë Bankare të datës 11.04.2017. Lidhur me këtë, në këtë seancë dorëzojmë edhe parashtresën për precizimin e kërkesëpadiës në kuptim të përfshirjes edhe të kamatës 8 %. Duke u bazuar në faktin që nga provat e administruara në këtë procedurë të konfliktit administrativ vërtetohet një gjendje tjetër faktike që dallon nga gjendja faktike e konstatuar nga e paditura në procedurë administrative, si dhe bazuar në faktin se e paditura përsëri e ka nxjerrë aktin e njëjtë të anuluar më parë me aktgjykimin e lartcekur, i propozojmë gjykatës që çështjen ta vendos vet në mënyrë meritore sipas propozimit të kërkesëpadiës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 12.07.2021, kundërshton pretendimet e paditësit si në padi dhe konstaton se vendimi kontestues është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm, dhe i propozon gjykatës që të merr Aktgjykim me të cilin refuzohet në tersi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të vërtetohet si i bazuar vendimi kontestues. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit gjyqësor edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, por me parashtresën e datës 26.09.2022 e ka arsyetuar mungesën, andaj gjykata ka vepruar në pajtim me nenin 41, të LKA-së. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës: 28.09.2022, ka administruar provat dhe atë : Vendimi 02/2020 i datës 26.02.2020, Përgjigja në Padi e datës

12.07.2021, Vendimi 96/2017 i datës 27.03.2017, Kundërshtimet e ushtruara në ATK, të datës 13.03.2017, Inicimi i Procedurës për Gjëbajtje 021/2017 i datës 13.02.2017, Vendimi për Lëshimin e Gjëbës 023/2017 i datës 14.02.2017, DUD-i R-3710 i datës 02.02.2017, CMR nr.203210, Raporti mbi Inspektimin i datës 02.02.2017, Dokumentet e Vendosjes së Ndëshkimeve MFA2R0000104015 dhe MFA2R000104016, Forma për Vizitat Përmbushëse e datës 03.02.2017, Fatura Nr. ... e datës 03.02.2017, Fletë Dërgesa Nr.009827 e datës 03.02.2017, Pagesat Bankare të datës 19.04.2017 dhe 11.04.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklaratimet në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se këtu paditësi ka pranuar Dokumentet e Vendosjes së Ndëshkimeve MFA2R0000104015 dhe MFA2R000104016, si dhe vendimin për Lëshimin e Gjëbës 023/2017 i datës 14.02.2017. Tutje nuk është kontestues as fakti se këtu paditësi me datë 13.03.2017 ka ushtruar kundërshtim në ATK-ë ndaj gjëbave si më lartë e për të cilin kundërshtim këtu e paditura fillimisht me datë 27.03.2017 ka sjell vendimin nr. 96/2017, e i cili vendim është anuluar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal A. nr. 757/17 datë 18.11.2019. E paditura duke vepruar sipas Aktgjykimit A. nr. 757/17 të datës 18.11.2019, në rivendosje ka sjell vendimin nr. 02/2020 datë 26.02.2020, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar prapë kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 09.04.2020, ka iniciuar prapë konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Gjykata e vlerëson si të paqëndrueshëm arsyetimin e Departamentit të Ankesave në vendimin kontestues për mungesën e dokumentacionit mbi origjinën e mallit gjatë transportit të tij me të vetmin argument se : *“çdo mall në vendin e tatimpaguesit, apo në qarkullim jashtë vendit të tatimpaguesit i cili nuk ka dokumentacion për të verifikuar pronësinë apo destinacionit, do të konsiderohet si një mall pa origjinë dhe do të nënshtrohet ndëshkimeve dhe veprimit administrativ sikurse është përshkruar në ligj, në veçanti veprimet e parapara në nenin 59 të ligjit”* , gjithmonë derisa vet inspektorët e të paditurës kanë ndërmarrë veprime dhe kanë vizituar terminalin doganor në Pejë me q’rast edhe kanë siguruar DUD-in R-3710/02.02.2017, për mallin lëndor kontestues e për të cilin DUD-ë këtu e paditura fare nuk është deklaruar duke e injoruar në tersi.

Tutje arsyetimin e të paditurës në vendimin kontestuese lidhur me mos pranimin e dokumenteve përcjellëse të mallit të paraqitura në procedurë administrative edhe pranë departamentit të ankesave pranë këtu të paditurës siç është Fletë dërgesa me nr. ... e datës 03.02.2017, duke u bazuar në deklaratën e vozitësit I.Xh, gjykata nuk e pranon si konstatim të saktë të gjendjes faktike përderisa në shkresat e lëndës askund nuk e kemi të administruar një deklaratë të tillë si të veçantë, përderisa i njëjti nuk është dëgjuar në procedurë administrative dhe as nuk është propozuar si dëshmitar pranë gjykatës, dhe përderisa dokumentet përcjellëse të mallit e dëshmojnë të kundërtën dhe atë Fletë dërgesa me nr. 009827 e datës 03.02.2017, dhe DUD-in R-3710/02.02.2017.

Konstatimi i të paditurës dhënë në arsyetim të vendimit kontestues së : *“lëshimi i ndëshkimit është vërtetim i gjendjes faktike në momentin e caktuar kohor”*, duke injoruar në tersi dokumentacionin tjetër përcjellës të mallit si më lartë, kjo gjykatë nuk mund ta pranoj si të tillë ngase nuk është as në pajtim me dispozitën nga neni 59, i ligjit 03/L-222, i cili përveç gjobës në rastet kur një person i angazhuar në aktivitet ekonomik posedon mallra pa origjinë ato mallra mund të merren dhe të mbahen në kujdestari të ATK-së me qëllim të caktimit të detyrimit penal. Në këtë rast, do të ndiqen procedurat për vlerësim për rrezik në nenin 21 të këtij ligji, dhe procedurat e marrjes së mallit dhe shitja e tyre do të rregullohet me dispozitat e neneve 34, 35 dhe 36 të këtij ligji, gjë që në rastin konkret nuk janë ndërmarrë edhe këto veprime nga e paditura.

Gjykata nga dokumentet përcjellëse të mallit të titulluara, DUD-i nr. R-3710/02.02.2017, CMR nr.203210, dëshmon në mënyrë të pakontestueshme origjinën e mallit, e kjo e paraparë shprehimisht edhe me dispozitën nga neni 9, par 1, i UA 15/2010, për zbatimin e ligjit 03/L-222, ku thuhet se *“Tatimpaguesit, duhet të jenë në gjendje të dokumentojë të gjitha mallrat nga koha e pranimit (qoftë përmes importimit, blerjes, apo shkëmbimit apo mënyrave tjera) deri sa ato të jenë shitur apo ndryshe të jenë sistemuar, përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemim tjetër. Në dokumentacionin e mundshëm që duhet të mbahet janë të përfshira: 1.1. Dokumentacioni Doganor – Dokumenti Unik Doganor (në vijim DUD) – Dokumentacioni doganor përfshinë të gjitha dokumentet që kërkohen nga Doganat e Kosovës (këtu e tutje DK), për importimin e mallrave në Kosovë. Dokument kyç për qëllime të ATK, është DUD, i cili është evidencë e pranueshme se mallrat kanë kaluar përmes kufirit dhe i kanë kaluar procedurat e doganave “*

Në fund Gjykata bazën ligjore të aplikuar nga e paditura në shqiptimin e gjobës administrative në shumë prej 1,000.00 euro për veprimet e këtu paditësit nga paditësit, e vlerësoj si aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kjo ngase dispozita referuese nga e paditura në nenin 53, par 2, nënpar 2.4, ku thuhet se : *“Mos krijimi dhe mos mbajtja e regjistrimeve Çdo person i nga i cili kërkohet të krijojë ose mbajë regjistrime sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe i cili nuk e kryen këtë do t'i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ si vijon: 2.4) tatimpaguesi me qarkullim vjetor prej pesëqind mijë (500,000) dhe më shumë – ndëshkim administrativ prej njëmijë (1,000) Euro”,* i referohet rasteve që lidhen me mos krijim dhe mos mbajtje të regjistrimeve, dhe jo si në rastin konkret kur kemi fletë dërgesën me nr. 009827 e datës 03.02.2017, DUD-in R-3710/02.02.2017 dhe CMR nr.203210, e të cilat dokumente dhe jo e kontestuar si dokument nga e paditura.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pakontestueshëm nga pikëpamja ligjore. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 43, par 3 dhe 46 par. 3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet

Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit dhe e obligoj të paditurën që paditësit t'ia kthej mjetet e paguara nga pagesa e gjobës administrative në shumë prej 6,032.51 euro, (gjashtëmijë/e/tredhjet/e/dy/euro/e/pesëdhjetë/e/një/cent), sipas dokumentit të vendosjes së ndëshkimit nr. MFA2R0000104015/14.12.2017, nga pagesa e gjobës administrative në shumë prej 1,000.00 euro, (njëmijë/euro), sipas dokumentit të vendosjes së ndëshkimit nr. MFA2R0000104016/14.12.2017, dhe atë në shumë të përgjithshme prej 7,032.51 euro, (shtatëmijë/e/tridhjetë/e/dy/euro/e/pesëdhjetë/e/një/cent).

Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi të datës 12.07.2021, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Kjo për faktin se paditësi pretendimet siç u vlerësuar edhe më lartë i ka bazuar në dokumentet të besueshme lidhur me origjinën e mallit të cilat janë administruar si prova nga gjykata dhe të cilat nuk ka mundur ti kundërshtoj as e paditura me ndonjë provë materiale.

Në lidhje me kamatën gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit në pajtim me dispozitën e nenit 57.4 të Ligjit nr.2044/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është parashikuar se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”* dhe dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*. Gjykata nga fletpagesat bankare të datës 19.04.2017 dhe 11.04.2017, vërtetoi pagesat e gjobave sipas

Dokumenteve të Vendosi së Ndëshkimeve MFA2R0000104015 dhe MFA2R000104016.

Gjykata vendosi për shpenzimet e procedurës në pajtim me nenin 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata komfor dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 3, dhe nenit 46 par 1 dhe 3 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.161/2022, datë 28.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.